VENDIM
Nr. 460, datë 26.7.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1001, DATË 2.12.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR INTEGRIMIN E SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS DHE SPITALIT USHTARAK TË FORCAVE TË ARMATOSURA NË NJË STRUKTURË TË BASHKUAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, të ligjit nr. 55/2022, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 147/2014, "Për shërbimin e urgjencës mjekësore", të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", dhe të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1001, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për integrimin e Spitalit Universitar të Traumës dhe Spitalit Ushtarak të Forcave të Armatosura në një strukturë të bashkuar", bëhen këto ndryshime:

1. Në bazën ligjore, togfjalëshi "... të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë" ..." zëvendësohet me "... të ligjit nr. 55/2022, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë" ...".

2. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Struktura organike e integruar e Spitalit Universitar të Traumës hartohet dhe miratohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe ministri i Mbrojtjes, sipas përgjegjësive specifike.".

3. Kudo në përmbajtjen e vendimit, emërtimet "Ministrisë së Shëndetësisë", "Ministria e Shëndetësisë", "ministri i Shëndetësisë" dhe "ministrit të Shëndetësisë" zëvendësohen, përkatësisht, me fjalët "... ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë ...", "... ministria përgjegjëse për shëndetësinë ...", "... ministri përgjegjës për shëndetësinë ..." dhe "... ministrit përgjegjës për shëndetësinë ...".

4. Pika 15 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"15. Ngarkohen ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe Ministria e Mbrojtjes për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku